

V E N D I M
Nr.320, datë 15.5.2003

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.405, DATË 8.1.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR DHE RRJETIT
RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Rrjetit rrugor kombëtar prej 3221 km rrugë (pika 1) i shtohen edhe 136 km rrugë.
 2. Lidhjes 1, “Rrjeti rrugor kombëtar”, që i bashkëlidhet vendimit (pika 1), i shtohen edhe këto emërtime:
 - “Drejtorisë së mirëmbajtjes së rrugëve, Librazhd
 - Librazhd-Steblevë 32 km rrugë interurbane, dytësore
 - Drejtorisë së mirëmbajtjes së rrugëve, Bulqizë
 - Steblevë-Bulqizë (Ura e Zallit) 39 km rrugë interurbane, dytësore
 - Drejtorisë së mirëmbajtjes së rrugëve, Vlorë
 - Kotë-Kuç-k/Sarandë 47 km rrugë interurbane, dytësore
 - Drejtorisë së mirëmbajtjes së rrugëve, Sarandë
 - Borsh-k/Vlorë 18 km rrugë interurbane, dytësore.”.
 3. Në tabelën “Inventari i rrugëve rurale, rajonale e komunale” (pika 4/1) hiqen emërtimet:
 - Librazhd-Steblevë
 - Steblevë-Bulqizë
 - Kotë-Kuç-k/Sarandë
 - Borsh-k/Vlorë.
 4. Në pikën 7 shtohet edhe Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit.
- Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano